



Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, **14.07.2022**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.07.2022 të parashtruar nga e OE **“EJONA” SH.P.K, Peje**; lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Rregullimi dhe riparimi i ashensoreve”** me Nr. të Prok: **616-22-2435-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 026 211** nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE **“EJONA” SH.P.K, Peje**; të dt. 12.07.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Rregullimi dhe riparimi i ashensoreve”** me **616-22-2435-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 026 211**, kundër Vendimit të Njoftimit të AK së, të datës: 07/07/2022 të publikuar në web-faqe të KRPP-së
2. AK vendos që ta kthejë në rivlerësim aktivitetin e prokurimit: **“Rregullimi dhe riparimi i ashensoreve”** me numër të prokurimit: **616-22-2435-2-1-1 dhe Nr. Brendshëm 616 22 026 211**, në mënyrë që komisioni për rivlerësim ta riezaminojë edhe njëherë ofertën e grupit të OE **“EJONA” SH.P.K, Peje**; për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE **"EJONA" SH.P.K** me datë 12.07.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Rregullimi dhe riparimi I ashensoreve"**, me Nr. të Prok: **616-22-2435-2-1-1 dhe numër te brendshëm 616 22 026 211.**

Autoriteti Kontraktues, me datë 14.07.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:


AK gjate vleresimit te ofertave ka marr per baze vleren e pergjithshme te kontrates ku si kriter ka qen se Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme ne vlere minimale 400,000 euro ne tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate dhe bazuar ne vleren e pergjithshme ka marr si te plotesuar kerkesen e kerkuar nga AK

Edhe pretendimet tjera janë pjesërisht te bazuara andaj AK do ta beje rivleresimin e ofertave gjithnje duke u mbeshtetur ne kerkesat e kerkuara ne Njoftimin per Kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit gjithnje duke u bazuar ne LPP dhe ne RRUOPP.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më larte ka vendosur si ne dispozitiv.
Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij Vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit